



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.10.2018
2. Miratimi i kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 05-23 nëntor 2018.
3. Miratimi i kalendarit për projektligjin “Për buxhetin e shtetit 2019”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e shtetit 2019”.
5. Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.
6. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian”.

Marrin pjesë: Bledar Cuci, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Beqja

Mungojnë: Genc Pollo, Aldo Bumci, Vangjel Dule, Grida Duma, Jorida Tabaku, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Ditmir Bushati - Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilda Dega – përfaqësuese e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori (buxheti) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Kuci – përgjegjëse sektori (akciza) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Jonida Kaza – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e radhës për Komisionin e Integritetit Europian me këtë rend dite:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.10.2018.

Miratimi i kalendarit të Komisionit për Integritetin Europian për periudhën 05-23 nëntor 2018.

Miratimi i kalendarit për projektligjin “Për buxhetin e shtetit 2019”; shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e shtetit 2019”.

Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian”.

Të ftuar në komision nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme janë zoti Ditmir Bushati, ministër, zoti Gazmend Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm, zonja Ilda Dega, përfaqësuese e Drejtorisë së Buxhetit. Nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë të pranishëm janë zonja Ina Dhaskali, përgjegjëse sektori në sektorin e buxhetit, zonja Enkelejda Kuçi, përgjegjëse sektori për akcizat dhe zonja Jonida Kaza, specialiste.

Fillojmë pa humbur kohë me pikën e parë, miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 18.10.2018. Procesverbali u është shpërndarë të gjithë anëtarëve nëpërmjet postës elektronike. A keni ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 18.10.2018.

Si pikë të dytë kemi miratimin e kalendarit të Komisionit të Integritetit Europian për periudhën 5-23 nëntor 2018. Kalendarit u është shpërndarë të gjithë anëtarëve nëpërmjet postës elektronike. A keni ndonjë sugjerim apo vërejtje? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika e tretë është miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”. Pra, dy datat që kemi lënë për shqyrtimin në parim dhe nën për nën. Kalendarit i buxhetit u

është shpërndarë të gjithë kolegëve nëpërmjet postës elektronike. A keni ndonjë vërejtje apo sugjerim? Nuk ka.

Kush është dakord me kalendarin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e shtetit 2019”.

Marrin pjesë:

Bledar Cuci, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Eglandina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Beqja

Mungojnë:

Genc Pollo, Aldo Bumci, Vangjel Dule, Grida Duma, Jorida Tabaku, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Ditmir Bushati - Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilda Dega – përfaqësuese e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori (buxheti) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Kuçi – përgjegjëse sektori (akciza) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Jonida Kaza – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Bledar Çuçi - Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e shtetit për vitin 2019”.

Fillimisht fjalën e ka ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Ditmir Bushati për të na thënë diçka në mënyrë të përmbledhur në lidhje me parashikimet që ka projektbuxheti i vitit 2019 sa i takon pjesës së integrimit europian.

Fjala për ju, zoti Ministër!

Ditmir Bushati - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë projektbuxhetin e vitit 2019, i cili është produkt i një pune të përbashkët edhe me institucionet e tjera dhe me një rol më të posaçëm natyrisht të Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë. Dihet që në 2019-ën, ne vijmë pas një eksperience të parë 1-vjeçare, ku Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme u krijua si bashkimi i dy institucioneve që operonin veçmas, Ministria e Jashtme dhe Ministria e Integrimit Europian. Në kuadër të ristrukturimit të dy institucioneve, viti i parë ka qenë relativisht vit testi për të kuptuar se ku jemi me kapacitetet tona njerëzore dhe sesi dy këmbët kryesore, njëra anë pjesa e shërbimit të jashtëm dhe ana tjetër pjesa e integrimit europian operojnë dhe ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

Për vitin 2019 kemi një rritje të buxhetit me rreth 3%, si pasojë edhe e angazhimeve që do të ndërmarrë Shqipëria në 2019-ën përtej elementeve klasike që mbulon buxheti i shtetit. Ky buxhet reflekton dhe mbështet prioritetet që mbulon institucioni që unë drejtoj. Së pari, e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe me fushën e veprimtarisë së komisionit tuaj në lidhje me prioritetin që ka të bëjë me integrimin europian të Shqipërisë, si dhe me komponentët kryesorë të tij. Ne sapo kemi nisur një proces pune voluminoz që ka të bëjë me skanimin apo inventarizimin e gjithë legjislacionit tonë përkundrejt legjislacionit të Bashkimit Europian. Këto ditë po zhvillohet edhe raundi i kapitullit tjetër në procesin *screening* shumë i rëndësishëm, duke qenë se ka nisur me kapitujt 23 dhe 24 në Bruksel, ku Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është përgjegjëse për drejtimin e këtij procesi. Krahas një elementi të dytë që ka të bëjë me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ne jemi përgjegjës për bashkërendimin e këtij procesi, ndërkohë që ministritë dhe institucionet e tjera janë përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Elementi i tretë ka të bëjë me ndërtimin e strukturave përgjegjëse shtetërore që do të përballojnë këtë proces nga *screening* e deri te traktati i anëtarësimit në Bashkimin Europian, një proces voluminoz, i cili do të kërkojë kohën e vet. Ne kemi përgatitur projektin e parë për ndërtimin e strukturave koordinuese, projektin e kemi bërë publik dhe në zbatimin edhe të ligjit për konsultimet publike kemi ndërtuar një kalendar se si do t'i thithim të gjitha opinionet që vijnë qoftë nga institucionet shtetërore, por edhe nga grupet e interesit, kryesisht nga shoqëria civile, bota e biznesit dhe bota akademike.

Në këtë kontekst dëshirojmë të kemi një bashkëpunim më të strukturuar me Këshillin Kombëtar të Integritit Europian, me Komisionin e Integritit Europian dhe me Komisionin e Politikës së Jashtme, sepse ka një vend për të gjithë këta aktorë në strukturën që do të ngrihet, sidomos në procesin e kanalizimit të opinionëve të instancave jashtështetërore dhe jashtëqeveritare në mënyrë që i gjithë procesi i ndërtimit të strukturave dhe i funksionimit të kësaj strukture të jetë sa më i qëndrueshëm dhe t'i shërbejë sa më mirë një procesi cilësor të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Elementi i katërt po në këtë drejtim ka lidhje me bashkërendimin e asistencës së Bashkimit Europian. Siç dihet, kjo asistencë ka ciklet e saj buxhetore, të cilët reflektohen edhe në projektbuxhetin që ne po diskutojmë sot, kryesisht me kontributin që vjen nga aktorët shtetërorë për një pjesë të mirë të fondeve, ku nevojitet që të ketë një bashkëfinancim. Ndërkohë, shpresoj shumë që Komisioni i Integritit Europian të bëjë një inventar të mirë edhe për institucionet e tjera, kryesisht për ato programe të Bashkimit Europian ku nevojitet një biletë hyrëse, që do të thotë se buxheti i shtetit duhet të jetë i angazhuar mbi bazën e institucioneve në mënyrë që të marrin pjesë në programe të ndryshme që ofron Bashkimi Europian.

Gjatë këtij viti ne do të kemi një kalendar të përcaktuar me Bashkimin Europian. Këtë javë ne kemi Këshillin e Stabilizim-Asociimit në Bruksel, që është instanca më e lartë përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe po operojmë në dy drejtime. Njëri prej drejtimeve ka të bëjë me vijimin e zbatimit të detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, sepse do të jetë një marrëveshje në fuqi deri në ditën që Shqipëria do të anëtarësohet në Bashkimin Europian, përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i kandidimit, pra ato detyra që shtëpie që ne vijojmë t'i bëjmë në funksion të thellimit të bisedimeve për anëtarësim, bazuar edhe mbi vendimmarrjen dhe kalendarin që vetë vendet anëtare miratuan në qershor të këtij viti.

Elementi tjetër apo shina tjetër ka të bëjë me atë që u përpoqa të sqaroj pak më lartë, përgatitjen e strukturave, ndërtimin, fuqizimin e kësaj strukture gradualisht, sepse nuk mund të ndërtohet dot brenda një dite me një përfshirje sa më të madhe të të gjithë aktorëve, qofshin aktorë politikë apo nga shoqëria civile. Në këtë drejtim ne krahas projektvendimit të Këshillit të Ministrave që do ta miratojmë pas procesit të konsultimit, do të hartojmë dhe miratojmë gjithashtu edhe një bazë normative me synimin që të jetë e qëndrueshme gjatë gjithë kohës që vendi do të jetë në bisedime për anëtarësim deri në momentin e anëtarësimit.

Janë edhe disa prioritete të tjera, të cilat lidhen më tepër me fushën e veprimit të Komisionit të Politikës së Jashtme, qoftë sa u përket elementeve që kanë të bëjnë me çështjen e sigurisë, marrëdhëniet me fqinjët dhe rolin e Shqipërisë në rajon. Fakti që ne kemi një rritje cilësore të buxhetit për 2019-en, ka të bëjë me aspiratën tonë për të drejtuar OSBE-në gjatë vitit 2020 dhe në rast se do të ketë konsensus për këtë aspiratë të Shqipërisë automatikisht në vitin 2019 Shqipëria përfshihet në trojkën e drejtimit të OSBE-së, çka do të thotë se një gjë e tillë do të përkthehet në aktivitete dhe në pjesëmarrjen e Shqipërisë në disa aktivitete të rëndësishme të OSBE-së jashtë apo brenda Shqipërisë dhe me një rol gjithnjë e më të madh, duke shkuar drejt 2020-ës, vit për të cilin ne mendojmë se do të jetë viti i presidencës shqiptare të OSBE-së.

Në këtë kontekst buxheti i shtetit mbështet edhe këtë lloj prioriteti të politikës sonë të jashtme. Edhe në këtë drejtim ne jemi duke u përpjekur për të krijuar një inventar të qartë të mundësisë, për të hartuar dhe strategjizuar prioritete të sakta për drejtimin e organizatës gjatë presidencës shqiptare, për rolin tonë më të fokusuar në Ballkan dhe Mesdhe, sidomos në momentin që do të hyjmë në trojkë, për burimet njerëzore dhe burimet financiare që do të duhet të vihen në dispozicion të kësaj sipërmarrjeje të rëndësishme, sepse është hera e parë, në rast se do të realizohet, që Shqipëria do të japë një kontribut të ndryshëm në këtë organizatë, në të cilën përgjithësisht të gjitha vendet e rajonit kanë qenë konsumatorë dhe tani është momenti për të qenë kontributor.

Elementet e tjera janë të lidhura me praninë tonë në NATO, siç e thashë edhe në fillim buxheti është një diskutim ndër-institucional dhe këtë vit në përputhje edhe me angazhimet që ka ndërmarrë qeveria shqiptare dhe Kryeministri në samitin e fundit në Bruksel, sa u përket edhe shpenzimeve dhe përmbushjes së të gjitha detyrimeve që burojnë nga anëtarësia jonë në NATO, gjithashtu ka një përmirësim të ndjeshëm çka në një mënyrë ose në një tjetër e lehtëson edhe punën e institucionit tonë dhe të shërbimit të jashtëm.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme, do t'i bie shumë shkurt, ka të bëjë me modernizimin e mëtejshëm të sistemit dhe të shërbimit konsullor. Kemi një pjesë që vijon dhe kryhet thjesht dhe vetëm nga ne dhe me mbështetjen buxhetore, e cila ka të bëjë me shërbimin *online*, me shkurtimin drastik të kohës dhe të shpenzimeve financiare për marrjen e një shërbimi. Viti që vjen është një vit përcaktues, sepse një pjesë e mirë e pasaportave skadojnë, duke qenë se janë shpërndarë në 2009-ën dhe të gjithë shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut, një pjesë e mirë e tyre, në bazë të parashikimeve tona, do t'i drejtohen shërbimit konsullor për të rinovuar pasaportën apo për të marrë një pasaportë të re dhe në këtë drejtim ne jemi duke punuar për t'i paraprirë kësaj situate dhe për të reduktuar në maksimum kohën brenda së cilës do të kryhet ky shërbim.

Krahas buxhetit tonë me vendimmarrjen e qeverisë, sipas së cilës një pjesë e mirë e shërbimeve elektronike ofrohen nga AKSHI në mënyrë të qendëruar, janë edhe dy procese të tjera, të cilat do të implementohen. Ato nuk janë pjesë e buxhetit tonë, pasi është një proces, i cili prokurohet dhe kryhet në të gjithë ciklin e tij nga vetë AKSHI që kanë të bëjnë qoftë me shërbimin e *e-viza*. Pra, shtetasit e huaj që dëshirojnë të vizitojnë Shqipërinë do të kenë mundësi ta marrin vizën në mënyrë elektronike dhe në këtë mënyrë i gjithë procesi do të kryhet dhe do të lehtësohet elektronikisht.

Së dyti, me përmirësimin e komunikimit të rrjetit tonë nga qendra në përfaqësi.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja nga prioritetet, ka lidhje edhe me diplomacinë ekonomike dhe me zhvillime, të cilat, sidomos gjatë vitit të fundit, kanë njohur një rritje pozitive. Ka një koordinim në nivel qeveritar qoftë për Agjencinë për Promovimin e Biznesit, qoftë për Agjencinë për Promovimin e Investimeve dhe të Turizmit për ta koordinuar të gjithë veprimtarinë me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Kjo do të jetë e reflektuar jo vetëm në buxhet, por edhe në veprimtaritë që do të zhvillohen jashtë vendit në këtë drejtim.

Dua t'ju them edhe diçka tjetër, pavarësisht se nuk vjen me këtë buxhet, sepse ka të bëjë me paketën tjetër që lidhet me pagat. Për herë të parë që nga viti 2006-2007 në 2019-ën, do të kemi një rritje të konsiderueshme të pagave për të gjithë personelin që është pjesë e shërbimit të jashtëm, me mbi 20%. Përveç kënaqësisë që kemi për këtë rritje dhe sensibilitet të qeverisë, sidomos të ekipit të financave shqiptare, besojmë se do të jetë një hap që do ta stabilizojë më tej karrierën brenda shërbimit, sidomos për sfidat e reja me të cilat do të përballët shërbimi mbi bazën e këtyre prioritetëve që u përpoqa t'ju nënvizoj.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Ministër, për këtë paraqitje të përmbledhur të çështjeve më të rëndësishme që lidhen me parashikimet buxhetore në fushën e procesit të integritit evropian të Shqipërisë!

A ka nga kolegët ndonjë pyetje specifike apo ndonjë sqarim për ministrin?

Po, zoti Balla e ka fjalën.

Taulant Balla – Unë dhe Ditmiri e kemi pasur praktikë që kur ishim në opozitë, bënim gjithmonë pyetjen, të cilën unë do t'ia bëj ministrit: A është i kënaqur me këtë buxhet ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe për angazhimet që ka ministria juaj për vitin buxhetor 2019?

Bledar Çuçi – A ka pyetje të tjera që t'i përmbledhim në mënyrë që të kemi vetëm një seancë përgjigjesh? Nuk ka.

Para se t'jua jap fjalën, zoti Ministër, në vazhdim të asaj që tha kolegu Balla, doja t'ju thosha diçka. Vjet, kur miratuam buxhetin e 2018-ës, ju kishit sjellë një parashikim se si do të shkonte buxheti i ministrisë suaj për 3 vjetët në vazhdim. Në tabelën përkatëse për 2019-ën ju kishit vënë një shumë, e cila pak a shumë ishte te 381 milionë. Nga kalkulimet që kanë bërë shërbimet e Kuvendit rezulton që buxheti që i dedikohet pjesës së integritit është diku te 331 milionë, pra është 0,13 më pak se parashikimi që keni bërë ju në 3-vjeçarin 2018-2020. Pyetja e kolegut Balla, ndoshta përforcohet edhe me një statistikë që vjen nga vetë buxheti dhe shqetësimi ynë mbetet nëse qeveria shqiptare do të jetë plotësisht e gatshme t'i përgjigjet sfidës së fillimit të çeljes së negociatave me Bashkimin Evropian dhe sidomos ngritjes së strukturave që ju sapo na thatë. Ju u shprehët se jeni në procesin e konsultimit të gjerë për të pasur një strukturë sa më eficiente dhe rezultative sa i takon pjesës së trupës që do të merret drejtpërdrejtë me fazën e negocimit.

Faleminderit!

Ditmir Bushati – Faleminderit për pyetjet dhe në të njëjtën kohë për mbështetjen!

Vjet ne kemi qenë në një situatë ku kemi testuar, siç e thashë, krijimin e institucionit që vjen si rezultat i bashkimit të dy institucioneve që operonin veçmas, të Ministrisë së Jashtme dhe Ministrisë së Integritit Evropian. Pjesa politike e procesit dhe e koordinimit është përthithur e gjitha nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, ndërkohë që pjesa, e cila vijon, ndonëse është brenda strukturës sonë, ajo që ju i referoheni si program integrimi, është kryesisht pjesa teknike që ka të bëjë me administrimin, bashkëfinancimin, TVSH-në dhe të gjitha detyrimet që ka

shteti shqiptar për programet e Bashkimit European, ku shteti shqiptar duhet të kontribuojë, sepse ka një tërësi programesh, të cilat vijnë në formën e asistencës teknike apo të granteve, ku shteti shqiptar nuk ka asnjë kontribut.

A mjafton buxheti? Asnjërit prej nesh nuk i mjafton buxheti, por çështja është që në kushtet kur në 2019-ën do të kemi një rritje prej 3% të buxhetit dhe do të mbështesim prioritetin tonë për të hyrë në trojkën e OSBE-së, mendoj se kemi arritur një sukses jo të vogël.

Së dyti, në kushtet kur pas një dekade për herë të parë ne bëjmë një rritje të pagave dhe trajtimin e gjithë personelit të shërbimit të jashtëm, si dhe të pjesës teknike që operon nëpër ambasada, besoj se duhet të ndihemi të kënaqur.

Së treti, shpresoj që këtë do ta demonstrojmë gjatë 2019-ës, struktura përgjegjëse shtetërore për gjithë këtë proces voluminoz vetëm një pjesë të saj do ta ketë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Pra, sekretariati i ekipit të negociatave apo sekretari i integritetit european do të jenë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, çka do të thotë që ne po punojmë edhe me departamentin e administratës publike, por edhe me institucionet e tjera që në çdo institucion të fuqizohen nuklat e menaxhimit të procesit të integritetit european në dy drejtime. E para, në drejtimin e koordinimit të të gjitha angazhimeve për të cilat jemi duke folur nga njëra anë, e dyta në shkrimin e projekteve, sepse kemi vënë re gjatë gjithë këtyre viteve, por edhe këtë vit që kemi mangësi dhe dobësi, sikundër në ndonjë rast procesi i ristrukturimit i ka fshirë si pa dashje edhe një pjesë të këtyre strukturave.

Në këtë kontekst jemi duke punuar me Departamentin e Administratës Publike, me Komisionin European për ta ndërtuar paralelisht dhe aty ku është rasti për ta fuqizuar këtë skemë. Çfarëdo që të bëjmë ne, sikundër e tregon edhe eksperiencia e vendeve të tjera, është e pamundur që gjithë këtë proces ta kopsitësh vetëm me burimet që ka administrata publike. Për këtë arsye ne kërkojmë bashkëpunimin e ngushtë me këtë komision, me Këshillin Kombëtar të Integritetit European dhe me Komisionin e Politikës së Jashtme, për të ndërtuar një mekanizëm më të mirë se si ta kanalizojmë procesin e konsultimit dhe të vendimmarrjes, sidomos kur të vijë puna që Shqipëria do të paraqesë pozicionin e saj negociues mbi çdo kapitull.

Në të njëjtën kohë u kemi kërkuar institucioneve të tjera, bie fjala Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të kenë barrën kryesore në këtë proces, sepse kanë mbi 60% të kapitujve të *acquis communautaire*, që edhe ato nga ana e tyre të listojnë ekspertët që janë në tregun privat apo nëpër universitete në mënyrë që kur të fillojë ky

proces, që është hapi logjik pas *screening*, edhe në qoftë se nuk e kanë ekspertin më të mirë në tryezë duhet ta kenë diku jashtë tryezës për të ndihmuar ekipin që do të jetë pjesë e këtyre diskutimeve dhe i përgatitjes së pozicioneve negociuese.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Pyetje të tjera me sa shoh nuk ka.

A ka diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Në bazë të Rregullores kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e shtetit për vitin 2019”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji “Për buxhetin e shtetit për vitin 2019”.

Faleminderit, zoti Ministër!

Ju jeni i lirë dhe mund të largoheni, por një përfaqësues juaji duhet të rrijë, pasi do të shqyrtojmë projektligjin për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk jeni ju? Në rregull.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë: Bledar Cuci, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Beqja

Mungojnë: Genc Pollo, Aldo Bumci, Vangjel Dule, Grida Duma, Jorida Tabaku, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori (buxheti) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Kuci – përgjegjëse sektori (akciza) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Jonida Kaza – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Bledar Çuçi - Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ju lutem, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të zënë vend!

Fjala është për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që të na paraqesin në mënyrë të përmbledhur se çfarë përmbajnë këto ndryshime që propozohen sot.

Enkelejda Kuci Faleminderit!

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, vjen në kuadër të paketës fiskale 2019, pra është pjesë e një sërë projektligjesh që po shoqërojnë paketën fiskale 2019-të. Ky projektligj ka disa synime, ku ndër më kryesorët është ndryshimi i nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, purot, cigarilos dhe cigaret me zëvendësues duhani. Akciza aktualisht nga niveli prej 4400 lekë për kilogram propozohet të shkojë në nivelin 6 mijë lekë për kilogram për këto produkte.

Një ndryshim tjetër është shtimi i një produkti të ri në kategorinë e mallrave të akcizueshme, i duhanit me ngrohje, në nivelin 6 mijë lekë për kilogram; heqja nga lista e mallrave të akcizës së fishekzjarrëve, llampave, pilave, baterive dhe po ashtu heqjen nga lista e mallrave të akcizueshme të rërës bituminoze, e cila realisht është e akcizueshme në nivelin 2 lekë për kilogramë. Vendosja e akcizës për produktin zhavorr bituminoz në nivelin 1 lek për kilogram; saktësimi i metodës së përlllogaritjes së akcizës për produktin nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike. Gjithashtu, me anë të këtij projektligji propozohen edhe disa ndryshime në kreun e shkeljeve në fushën e akcizës, si dhe saksionet përkatëse.

Ligji që po propozojmë është një ligj i përafruar pjesërisht me direktivën e Këshillit 2011/64, datë 21 qershor 2011 mbi strukturën dhe normat e akcizës që aplikohen për duhanin e prodhuar. Pak a shumë këto janë pikat kryesore, të cilat propozohen me anë të këtij projektligji.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Para se të kalojmë te pyetjet dhe diskutimet nga kolegët, shkurtimisht do të doja një opinion nga shërbimet e Kuvendit në lidhje me përafrimin, pavarësisht se niveli i përafrimit të këtij ligji është i pjesshëm.

Fjalën e ka zoti Kasneci për t’i informuar kolegët se si qëndron kjo çështje me direktivën përkatëse.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse u prezantua edhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është e përafuar pjesërisht me aktin përkatës të BE-së, që është direktiva e vitit 2011/64 e BE-së e datës 21 qershor 2011 “Për strukturën dhe normat e akcizës, që aplikohen për duhanin e prodhuar”. Pra, projektligji për afrohet pjesërisht me direktivën. Nga shqyrtimi që ne kemi bërë rezulton që përafrimi është korrekt dhe i saktë. Te shënimi në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit, është bërë një saktësim, pasi një referencë e BE-së është dhënë në anglisht “EU” dhe duhet bërë në shqip “BE”. Këtë e kemi konsultuar paraprakisht edhe me ekspertin e ministrisë dhe është shprehur dakord.

Faleminderit!

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Nga kolegët a ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Meqë jemi edhe komision për dhënie mendimi, mendoj që, sipas Rregullores dhe traditës së këtij komisioni, të përgatisim relacionin përkatës me këtë sugjerim që sapo dëgjuam dhe t’ia përcjellim Komisioni të Ekonomisë si komision përgjegjës.

Kush është dakord me këtë formulim për relacionin? Dakord. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Faleminderit, zonja!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian”.

Marrin pjesë:

Bledar Cuci, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Ilir Beqja

Mungojnë:

Genc Pollo, Aldo Bumci, Vangjel Dule, Grida Duma, Jorida Tabaku, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Ditmir Bushati - Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilda Dega – përfaqësuese e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori (buxheti) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Kuci – përgjegjëse sektori (akciza) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Jonida Kaza – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Bledar Çuçi – Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit

European, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit European”.

Shkurtimisht nga shërbimet e Kuvendit do të dëgjojmë për çfarë bën fjalë ky ndryshim dhe pastaj kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Fjala për ju, zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i projektligjit “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit European” është pikërisht ratifikimi i ndryshimeve të këtij memorandumi.

Programi i drejtësisë së BE-së për drejtësinë është krijuar me rregulloren e Bashkimit European të vitit 2013. Objektivi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të një zone europiane të drejtësisë, e bazuar në njohjen e ndërsjellë dhe besim reciprok, në veçanti përmes nxitjes së bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale. Ky program ka katër komponentë, por tre komponentët e parë janë ratifikuar tashmë me ligjin e vitit 2017. Tre komponentët e parë: bashkëpunimi gjyqësor, trajnimi gjyqësor dhe aksesimi në drejtësi ishin në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë, kurse komponenti i katërt që lidhet me drogat, ishte në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme. Pas miratimit të tre komponentëve të parë, nga Komisioni European është kërkuar dhe është rënë dakord për të ndryshuar memorandumin për të zgjeruar fushën e tij të veprimit dhe të objektit, me qëllim që të përfshihet edhe lufta kundër drogës.

Ky ndryshim memorandumi synon të zgjerojë objektin e tij, duke përfshirë në fushën e tij të veprimit edhe objektivin e katërt të programit, që lidhet me lëndët narkotike, i cili i përket fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme.

Gjithashtu, parashikohet edhe amendimi i aneksit 1 të memorandumit të mirëkuptimit, i cili parashikon aspektet financiare. Pra parashikohet financimi i tij për vitet 2017-2020, ku 6 mijë euro do të jenë për komponentin e katërt të luftës kundër drogës.

Ky projektligj nuk përafron ndonjë akt ligjor të BE-së, por, pavarësisht kësaj, ai është në përputhje me nenet e Traktatit të Bashkimit European, pra neneve 81, 82 dhe 84, të cilat parashikojnë bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile dhe penale, që kanë pasoja ose rrjedhoja ndërkufitare ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Është gjithashtu në përputhje me nenet përkatëse të MSA-së, nenet 1 dhe 78, të cilat parashikojnë që Shqipëria dhe BE-ja i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës dhe forcimit të institucioneve të të gjitha niveleve në përgjithësi, si dhe funksionimit të politikës dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit në veçanti.

Gjithashtu, kjo marrëveshje është në përputhje me nenin 5 të marrëveshjes kuadër, që është lidhur midis BE-së dhe Shqipërisë “Për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e BE-së”, ku parashikohet që për programe të caktuara bëhen marrëveshje.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me këtë marrëveshje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Mbledhja e ardhshme do të jetë në datën 26, jo në orën 10, me propozim të zotit Balla, po në orën 12.00, për të shqyrtuar projektbuxhetin nen për nen dhe në tërësi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Para se ta mbyllim mbledhjen, ka një propozim nga zoti Balla që shqyrtimi nen për nen të bëhet në datën 22 nëntor, në orën 9.30 në sallën e seancës plenare.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA